

LETËR PËR HAPJEN E SHKOLLËS

Letër për njoftimin e prindërve dhe nxënësve në përgatitjen e tyre për ditën e parë të shkollës, mbas procesit të mbylljeve, zhvendosjeve dhe shkrirjes së shkollave



Të dashur Prindër, Kujdestarë dhe Partnerë të Komunitetit,

Ndërsa viti shkollor është drejt përfundimit, do të dëshiroja të shprehja falenderimin tim për kohën dhe energjinë që i kushtuat procesit të Masterplanit të Mjediseve (FMP) dhe t'ju vija në dijeni për përgatitjet e Drejtorisë Arsimore për fillimin e vitit të ardhshëm Shtator.

Këtë Vjeshtë, 53 shkolla do të pranojnë nxënës të rinj, si rezultat i mbylljeve, zhvendosjeve dhe shkrirjes të ndryshme, të miratuara nga Komisioni i Reformës Shkollore (SRC). Puna po kryhet me shpejtësi, që të gjitha shkollat dhe nxënësit të kenë një tranzicion sa më të mirë. Deri më tani, çdo nxënës që ndikohet nga ky proces, ka marrë një letër ku përcaktohet shkolla e tij për vitin shkollor 2013-14. Në vazhdim, është kryer afër 40 përqind e punës që duhet të përfundojë përpara fillimit të vitit shkollor. Pjesa tjetër e punës do të kryhet pas përfundimit të këtij viti shkollor, që përfundon në 21 Qershor.

Drejtorja Arsimore është e përkushtuar në informimin e nxënësve, prindërve, personelit dhe partnerëve të komunitetit, për këtë proces. Ne do të bëjmë përditësime në uebsajtin e Hapjes së Shkollës (www.philasd.org/schoolopening) dhe do të japim Lajmërimi për Hapjen e Shkollës, çdo dy javë. Përditësimet për konditat e Mjedisit të shkollave, klimës dhe sigurisë, programeve të nxënësve dhe planifikimet për vizitat e hapura në shkollat pritëse, do të jepen online dhe me letra njoftuese.

Drejtori i shkollës së fëmijës tuaj, gjithashtu do të jetë në kontakt me ju gjatë muajve të verës, për informacione shtesë. Unë kam bindjen se me përshtatjen e mjediseve dhe burimeve me madhësinë e shkollave, ne kemi hedhur bazat përmirësuese për mësim, për të gjithë nxënësit. Unë ju inkurajoj që të qëndroni të angazhuar në këtë proces dhe të dërgoni pyetjet tuaja në schoolopening@philasd.org. Bashkërisht ne do të garantojmë që nxënësit e Filadelfias të marrin edukimin që ata meritojnë.

Edhe njëherë faleminderit për mbështetjen tuaj,

William R. Hite, Jr., Ed.D

Si është gjendja?

Një tablo e progresit të Drejtorisë në përgatitjen e shkollave pritëse për vitin e ri shkollor:

Përqindja e..

Shkollave pritëse që duan regullim të mjediseve të shkollës 100%

Shkollave pritëse që kanë bërë regullim të mjediseve të shkollës 40%

Shkollave të mbyllura me inventar të plotësuar për programet e reja 91%

Nxënësve, të cilëve u është dërguar letër që përcakton shkollat e tyre të reja, për vitin shkollor 2013-14 100%

Regjistrohuni që të merrni email rreth procesit të tranzicionit në:

www.philasd.org/language/albanian/help.

Nxitni Bashkëpunime Pozitive për
Përmirësimin e Klimës dhe Sigurisë në
Shkollë

Drejtoria Arsimore e Filadelfias lëshoi këtë javë një grant shumëvjeçar prej \$730, 676 për përmirësimin e klimës në shkollë, nga "Philadelphia Foundation's Fund for Children". Shkollat që do të marrin pjesë në këtë grant, janë përzgjedhur ato shkolla që do të presin nxënës të rinj këtë vjeshtë. Shkollat do të implementojnë dy programe, Ndërhyrjet dhe Mbështetjet e Sjelljeve Pozitive, (PBIS), dhe Praktikrat Restauruese. PBIS do të implementohet në këto shkolla: Penrose, Rhodes, Lea, Rudolph, Hartranft, Tilden, Duckrey, Roberto Clemente, Martha Washington, dhe William McKinley. Praktikrat Restauruese do të implementohen në shkollat: Ben Franklin, High School of the Future, John Bartram, Martin Luther King, Morris E. Leeds, Overbrook High School, Robert Morris, Roxborough, South Philadelphia, dhe Harding.



Nisma Nëpërmjet Korridoreve të Sigurta, Drejtoria Arsimore e Filadelfias dhe agjensi të qytetit, përfshirë Departamentin e Policisë të Filadelfias, SEPTA dhe Zyrën e Shërbimeve Vullnetare, do të punojnë bashkërisht për identifikimin e rrugëve më të sigurta në rrugëtimin e nxënësve nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas. Në mënyrë më specifike, grupi do të përcaktojë pikat e nehta, kryqëzimet më të mëdha, rrugët e gjëra dhe të tjera, që ndikojnë në sigurinë e nxënësve. Mendimet e grupit do të përdoren për rrugën e lëvizjes së nxënësve dhe rivendosjen e rojeve të kalimeve. Kryebashkiaku Michael A. Nutter ka shtuar 10 ekipe për Koridore të Sigurta me fondet e qytetit, për mbështetjen e nxënësve dhe familjeve.



Duke filluar këtë vjeshtë, South Philadelphia High School dhe Martin Luther King High School do të jenë partnere me "Outward Bound", ofruer me përvojë i programeve që zhvillohen jashtë mësimit. Që prej vitit 1962, "Outward Bound" ka tërhequr më shumë se 1 milion njerëz në aventura që ndërtojnë karakteret, mësojnë aftësitë drejtuese dhe frymëzojnë etikën e shërbimit. Nxënësit e "South Philadelphia High School, Bok Technical Institute" dhe MLK, këtë vjeshtë do të marrin pjesë në ekipet që trajnojnë drejtimin. Ky bashkëpunim do të krijohet nga Zyra e Mbrojtjes së Shkollave të Sigurta dhe Rrjeti i të Rinjve të Filadelfias. Për më shumë informacion, vizitoni www.outwardbound.org/.



Martin Luther King (MLK) High School do të bashkëpunojë me "Philadelphia Urban Youth Racing School", vitin e ardhshëm në përpjekje për zgjerimin dhe zmdhimin e programit të saj së inxhinierisë së automjeteve, Urban Youth, themeluar në 1998, nxit nxënësit të vazhdojnë

Nr. Telefonikë më të përdorur

PER PYETJE RRETH...	KONTAKTONI
Pasurimit dhe Mbështetjes Mësimore Ofron udhëzime dhe kualifikim profesional për mësuesit në fushat e muzikës, artit, vallëzimit, teatrit, edukimit fizik, gjuhëve të huaja, jashtë kohës shkollore	215-400-5902
Frekuentimit dhe Mungesave Ofron shërbime mbështetëse për shkollat në përmirësimin e frekuentimit dhe uljen e largimeve	215-400-4220
Edukimi Tekniko Profesional Ofron programe dhe shërbime për nxënësit e angazhuar në Edukimin Tekniko-Profesional	215-400-2331
Fëmijëria e Herëshme Ofron programe dhe shërbime për fëmijët e moshës 0-6 vjeç dhe familjet e tyre	215-400-4270
Angazhimi i Familjes & Komunitetit Aftëson familjet dhe komunitetin në arritjen dhe përfshirjen në programet dhe shërbimet e Drejtorisë Arsimore	215-400-4180
Edukimi Shumëgjuhësor Ofron shërbime shumëgjuhëshe dhe mbështetje për nxënësit dhe familjet	215-400-4240
Sistemimi i Nxënësve Vlerëson kërkesat e transferimit të nxënësve dhe përcakton shkollat e tyre	215-400-4290
Rekordet e Nxënësve Mban dhe proceson kërkesat për rekordet e nxënësve (transkriptet, verifikimet, fletëthirrjet, rekordet e paaftësisë etj)	215-400-4780
Shërbimet e Specializuara Ofron shërbime të edukimit special, mbështetjes së specializuar dhe ato shëndetësore të nxënësve	215-400-4170
Siguria e Shkollës Angazhon administratorët e shkollës, policët, nxënësit, prindërit dhe antarët e komunitetit për rritjen e sigurisë në shkollë dhe përreth saj	215-400-4710
Transporti Ofron transport të sigurtë për nxënësit e Filadelfias që vazhdojnë shkollat publike, private, çarter dhe ato fetare	215-400-4350
Informacione të Përgjithëshme	215-400-4000

karrierën në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë (STEM). Bashkëpunimi do të prezantojë më tepër nxënës në aspektet mësimore dhe sportive të motorave, duke i mësuar atyre pjesë të biznesit të industrisë së makinave. Për më shumë informacion, vizitoni www.uvrs.com.





Lista e Plotë për në Shkollë

Përdorni listën tonë për shtatorin e ardhshëm!

- Njihni shkollën e fëmijës për vitin 2013-14. Të gjithë nxënësit kanë marrë një letër nga Zyra e Regjistrimit dhe Caktimit të Nxënësve. Në rast se nuk keni marrë një letër të tillë, ju lutemi telefononi 215-400-4290.
- Shikoni kalendarin e vitit të ardhshëm mësimor.** Kalendarin Mësimor për vitin e ardhshëm shkollor është online në www.philasd.org/language/albanian/calendar. Dita e parë e shkollës është 9 Shtator.
- Regjistrohuni të merrni informacion dhe përditësime për procesin e tranzicionit.** Vizitoni www.philasd.org/language/albanian/help për më shumë informacion.
- Finalizoni planet e transportimit. Zyra e Shërbimeve të Transportit do të përcaktojë vlefshmërinë e nxënësve për transport me autobusin e shkollës, ose me SEPTA_n, bazuar në kriteret e vendosura nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias. Në rast se fëmija juaj plotëson këto kriteret, ju do të merrni një letër nga Zyra e Shërbimeve të Transportit, gjatë muajve të verës.
- Përgatitni Uniformat Shkollore. Nxënësit e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, kërkohet të vishen me uniformë. Për të shikuar politikën e veshjes në shkollë, ju lutemi vizitoni , www.philasd.org/schoolopening.
- Ndiqni Takimet** Familja dhe Edukimi. Bashkohuni me ne në takim "Family & Education Reunion" ditën e Shtunë datë 10 Gusht, nga ora 8 a.m. to 5 p.m. për dhurata falas, seminare edukative dhe të tjera! Takimi do të zhvillohet në "School of the Future" me adresë, 4021 Parkside Ave.
- Ndiqni një Vizitë të Hapur** (Open House): Zyra e Angazhimit të Familjes dhe Komunitetit ka planifikuar një Vizitë të Hapur (Open Houses), në çdo shkollë pritëse. Një listë e këtyre Vizitave do të postohet në uebsajtin e "School Opening", në mesin e muajit Korrik.

Qëndroni në kontakt!



LINJA DIREKTE NË GJUHËN SHQIPE
ALBANIAN HOTLINE



Hezitoni të telefononi Drejtorinë Arsimore për shkak të vështirësive gjuhësore?
Nuk dini Ku dhe Kujt t'i drejtoheni për ndihmë?

Linja Direkte në Gjuhën Shqipe është zgjidhja juaj!

215-400-8480